

De Rada – Këngët e Milosaos

-Pyetje me shittjellim-

-shënime-

Cila është periudha dhe vendi i ngjarjeve në poemën “Milosao”?

Si realizohet nënteksti i poemës?

Prej nga buron konciziteti?

E ç’lloji mund të konsiderohet poema? Pse?

Cilat janë pengesat që realisti De Radë i vë përballë dashurisë?

A është zgjidhje tërmeti?

Cili është kuptimi i vdekjes së Rinës?

Si shfaqet motivi atdhetar në poemë?

Cilat janë idetë dhe mesazhi i veprës?

-shënime-

Cilat janë personazhet kryesore të veprës?
Tregoni tipare të tyre.

*Milosao –**Rina –**Zonja Mëmë –***Kënga I**

Identifikoni vargjet ku shprehet:

-Ripërtëritja e natyrës.

-Frymëzimi poetik.

-Stina pranverës.

-Kthimi i poetit në mjedisin familjar.

Ardhja e pranverës përcillet përmes elementeve të natyrës dhe të botës njerëzore. Gjejini ato.

Cilat ndjenja gërshetohen natyrshëm dhe bëjnë të lindë hareja në shpirtin e Milosaos?

-shënime-

Çfarë realizon kundërvënja e re – e moçme në vargjet:

*kaltëronte n'ditn' e re.
Por lumbardha e Anakreontit
Në Temp rronte e moçme*

Gjejeni këtë mesazh edhe në vargjet:

*Veç që atë s'e thau bora
s'e përgjaku heshtëza*

A ndihet vetëdija e poetit se është i zgjedhuri nga muza poetike?

Në cilat vargje duket kjo?

Analizoni lidhjen që krijohet ndërmjet vargjeve.

rrusht' pak aguridhe

dhe

*...si hareja kur te shtrati,
mbrëmanet, vajza e ngrohtë
ndien për të parëzën
sisët që m'i fryhen.*

Shkruani mesazhin universal të këngës hyrëse që lidhet me kultin e gëzimit të jetës.

Për t'u përgjigjur drejt kërkoni vargjet në të cilat shfaqet gëzimi i jetës, të cilin De Rada si romantik e ka ngritur në kult (e adhuron, e himnizon).

A duket e natyrshme që heroi (dhe De Rada) ta shohë gëzimin e jetës te vajza e mitur që për herë të parë ndjen se bëhet femër?

Kini parasysh që De Rada kur e shkroi këtë poemë ishte veç 20 vjeç.

-shënime-

Kënga V**Çfarë simbolizon deti për arbëreshët?****Cila është gjendja që përcjellin vargjet e para të këngës?***Përse të venë në det
mendimet, zemra ime?**Deti dhe shqiptarët; a janë shqiptarët njerëz të
detit?***Cilat janë shenjat paralajmëruese që e përcjellin të
plotë gjendjen e shqetësuar?****Ç'rol stilistik luan shenja paralajmëruese?****Gjejeni atë dhe thoni si është realizuar nga ana
gjuhësore.****Cila është lidhja që vendoset mes jetës, vdekjes dhe
detyrës në vargjet e mëposhtme:***Doemos do vdesim
në shtrat, në mos rënçim
përpara shtëpive tona***Çfarë kuptojmë nga thirrja “Erdhi dita e Arbrit!”?****Bëni lidhjen mes vdekjes, harresës dhe kujtesës në
shkallëzimin e vargjeve të mëposhtme:***e nën dhe do na harrojnë
shokët e vëllezërit
krojet e katundi ynë.***Kjo këngë zhvillohet në bazë të dy motiveve (të cilat
janë dhe motivet e gjithë poemës).
Gjejini ato.**

-shënime-

Gjeni cilësi të Milosaos dhe Rinës që dalin në këtë këngë.

Flisni për karakterin e të dyve, bazuar në këto cilësi të tyre?

Cilat janë vargjet që mbajnë peshën e gjithë këngës?

A i realizohet kjo dëshirë Milosaos?

Veç në sy të shihemi

Pa dhe bota të përmbysset.

Dy dëshirat ose betimet e Milosaos shprehen në vargjet:

1. *Erdhi dita e Arbrit!*

2. *Veç në sy të shihemi*

Pa dhe bota të përmbysset.

A e kundërshtojnë/përrjashtojnë njëra-tjetrën këto dy dëshira (betime)? Argumentoni.

-shënime-

Kënga XXX

Është kënga e fundit e poemës. Bëni një përshkrim të situatës në të cilën vendoset kjo këngë.

Konciziteti / lakonizmi i gjuhës poetike të De radës.

Nënvizoni vetëm vargjet në të cilat tregohet se Milosaoja është i plagosur në luftë, janë orët e tij të fundit, por detyrën e ka kryer, sepse qyteti ka shpëtuar.

Gjaku im te Lumi i Vodhit.

Hapeni shatoren,

o ushtarë...

atje nuk do zgjohem më...

Mblidhen shokët mbrëmanet

në katund, në vatërët.

Në cilat vargje mund të kuptojmë stinën?

Jepni mendimin tuaj, pse natyra e kësaj kënge të jetë pikërisht kjo?

Vini re emocionin e fortë që përcjellin fjalët, më mirë, mendimet e fundit të heroit.

Përcjellja e emocionit realizohet përmes disa fjalëve apo situatave kyç të këngës? Gjejini ato.

1. Shkruani një ese me temë:

Bëni një paraqitje me shkrim të mendimit tuaj mbi mesazhin e vargut të fundit të poemës.

Unë i lashë si ëndërrëz.

Jeta është e shkurtër, gati një iluzion, që nuk e merr vesh kur kalon etj.

2. Shkruani një ese me temë:

Koncepti i detit në mentalitetin poetik arbëresh.